

Nderveprimi me mjedisin

Tema: Projekti i shfrytezimit te Gelqeroreve,Zona nr.376/7,VOKOPOLA”

Shtojca 1 pika 19.Gurore dhe miniera siperfaqesore,ku siperfaqja e vendit eshte mbi 0.5 Hektare,ose vendet per nxjerrjen e torfes ku siperfaqja e vendit eshte mbi 1 hektar.

Subjekti: “ KLISAL” sh.p.k

Punoi: GEC studio

Hartoi :Ing Dhurata Lumani



Qellimi I subjektit

Studimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM) per aktivitetin shfrytezim guri gelqeror me kariere (grupi mineraleve metalore) ne territorin e Bashkise SE Ures Vajguore rrethi Berat u pergatit me kerkese te subjektit « KLISAL» shpk per lejes minerare .

Studimi percakton detyrat dhe mjetet e nevojshme per arritjen e misionit dhe objektiveve ne jeten e komunitetit . VNM e ketij studimi eshte hartuar per te integruar mbrojtjen ambjentale, ne jeten e perditeshme, ne ndryshimin e sjelljes se komunitetit duke u bere ne kete menyre foca shtytese e permiresimit te vazhdueshem te ndergjegjesimit.

Ne zbatim te urdherit te Ministrit te Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave, nr.3 date 17/05/2006 « Per rehabilitimin e siperfaqeve te demtuara nga shfrytezimi i mineraleve metalore e jo metalor» dhe ne mbeshtetje te Ligjit nr.8934 date 05/09/2002 « Per Mbrojtjen e Mjedisit », Subjekti «KLISAL» shpk ka hartuar projektin e rehabilitimit te karrieres e ne vijim, pergatitjes ,shfrytezimit dhe ne mbyllje te aktivitetit.

Ne procesin e shfrytezimit te karrieres do te punohet sipas projektit te pergatiturr pas miratimit te tij ne Institucionet lejedhenesedhe institucionet vartese ne kohen e marrjs se lejes minerare. Sikunder duket edhe nga fotot dhe planimetria me gjendjen e karrieres ne fund te vitit 2015, objekti paraqitet mire ne drejtim te parametrave te shfrytezimit.

Per periudhen deri Tetor 2015 prodhimi i realizuar ka qene ne pershtatje me kerkesat e tregut rajonal dhe zona per rreth.Ne kete kuader edhe projekti qe paraqitet ploteson kerkesat e ligjit minerar Shqiptar per rinovim leje mbas periudhes dhjetevjeçare.

Hartimi i projektit kerkon te vijohet te shfrytëzohen gur gëlqeror, qe klasifikohen ne grupin mineralet dhe materialet e ndërtimit.

Shfrytëzimi do të vijoje te bëhet me kariere te tipit te dyte, ne perputhje me ligjin e sipërcituar.

Materiali i prodhuar nga ky aktivitet, përdoret kryesisht si lende e pare per prodhim inrtesh, rere, çakell, granil etj ne impiantin e ngritur prane objektit.

Sterilet dhe lende te tjera te padobishme mund te perdoren ne fusha te tjera te ndryshme si stabilizant ne shtrim rruges etj.

Shoqeria , ka kryer investime te nevojshme ne objekt dhe konkretisht Impiant thyerje dhe franksionimi, mjete ngarkimi fadrom dhe katerpilar mjete transporti.

Ne teresi keto investime jane te konsiderueshme dhe garantojne pune normale edhe ne te ardhmen.Nisur nga Investimet e kryera, Gjendja e rezervave, kryerja e punimeve siaps projektit qe po prezantohet, tregu i garantuar i subjektit KLISAL paraqet projektin e mbylljes perfundimtare dhe te rehabilitimit,konforme kerkesave te ligjit 10304 date 15.07.2010

Zona qe kerkohet te shfrytëzohet nuk eshte e pyllezuar ,nuk ka objekte industriale ,objekte banimi si dhe vepra arti .

Projekti i hartuar ka per qellim studimin e mundesise se shfrytezimit te objekti te gelqeroreve ne zonen konkuruese NR 376/7 te objektit “Vokopola” nga subjekti privat “Klusal” sh.p.k., qe ka fituar me konkurim te drejten per te pergatitur dosjen per pajisjen me leje minerare shfrytezimit.

Per hartimin e studimit tekniko-ekonomik dhe projektit te shfrytezimit te ketij objekti jane mare ne konsiderate :

- Pozicioni gjeografik dhe mardheniet e objektit me qendrat e banuara;
- Topografia dhe klima e zones ne te cilen ndodhet objekti i marre ne konsiderate;
- Hidrologjia dhe hidrigrafia e zones ne te cilen kufizohet objekti i shfrytezimit;
- Gjendja e infrastruktures se rajonit, mundesite e permiresimit te saj, ndertime dhe instalime te tjera te domosdoshme per shfrytezimin e objektit nga pikpamja minerare;
- Materiali gjeologjik baze lidhur me ndertimin gjeologjik te rajonit dhe objektit, sasine dhe cilesine e rezervave gjeologjike dhe te shfrytezueshme sipas llojit te gurit gelqeror te mermerizuar dhe produkteve apo mbetjeve te tjera te ndryshme brenda kufijve te percaktuar te shfrytezimit;
- Kerkesa te ndryshme per makineri, pajisje instalime, linja dhe investime te tjera per pergatitjen dhe shfrytezimin e objektit.
- Llojet e produkteve te prodhuara dhe tregu i shitjes se tyre

ZONA KU DO TE KRYHET AKTIVITETI ESHTE E CVESHUR NGA BIMESIA ME FLORE DHE FAUNE TE DOBET NGA VEPRIMTARIA E NJERIUT NGA PRERJA E DRUREVE DHE PERDORIMI PER KULLOTA.

Pozicioni gjeografik (Vendndodhja)

Vendodhja e rajonit te objektit te mineralit

Objekti ben pjese ne bashkine Ura Vajguore, Berat. Ne veriperendim kufizohet nga lagje te Vokopoles ; ne perendim nga fshati Vokopole, ne lindje nga g nga kodra e Konizbaltes, ne perendim nga fshati Konizbaltes, Vet zona shtrihet ne pjerresite e malit te Skrevanit, me lartesi 430.5m dhe zbret ne drejtim te lindjes ne ultesirat me kuota +100m . Vet objekti vendoset midis kuotave +110 dhe deri ne +275 m mbi nivelin e detit

Zona ne te cilen ben pjese objekti eshte zona Jonike nenzona e Mallakastres qe eshte njekoheishtzona me e madhe kodrinore e vendit tone, me nje siperfaqe rreth 1000 km². Shtrirja e pergjithshme e Mallakastres nga veriu ne jug eshte 60 km, kurse nga lindja ne perendim eshte rreth 40 km.

Per sa i perket kushteve natyrore, Mallakastra perben nje zone kalimtare nga Ultesira Bregdetare per ne krahinen malore jugore. Nga pikepamja etnografike ajo eshte gjithashtu nje zone kalimtare midis Myzeqese dhe Laberise. Mali me i larte ne zone eshte mali i Shpiragut me lartesi 1197.2 m, qe pasohet ne veri nga lartesi 709 ne Mbreshtan, Mali i Skrevanit 430 m, dhe vargu i Kodrave te Gorices te cilat ulen ne lartesi ne drejtim te veriut nga 295 m deri ne 161 m.

Objekti i kerkuar per shfrytezim shtrihet ne veri te Kodres se Konisbaltes.

Mbulesa bimore perfaqesohet nga kati i shkurreve mesdhetare. Ajo eshte e pasur dhe e ndryshme nga njeri shpat ne tjetrin. Lugina e Osumit dallohet per prodhimin e dritherave te bukes, perimeve, farogjereve, frutikultures, etj. Zona ku do te zhvillohen punimet eshte e zhveshur nga bimesia.

Rilevimi te zonës që kërkohet me koordinatat përkatëse ne plan, ndërtesat ekzistuese ose ndonjë objekt tjetër brenda zones.

Objekti ben pjese ne harten topografike te shkalles 1 : 25 000 me nomenklature K – 34 – 112 –D – a - 4 dhe K – 34 – 112 – D – c - 2 .

Siperfaqja e zones per shfrytezim eshte **0.554km²**

Relievi eshte i thjeshte dhe i rregullt; ai vjen e ngrihet nga niveli i Osumit ne Kodren e Gorices me lartesi 99 m, Kodren e Konisbaltes me lartesi 259 m, Mbreshtanin me lartesi 295 m dhe kulmon ne lartesine 1179,2 m te malit te Shpiragut.

Topografia dhe klima e zones.

Nga ana morfologjike, relievi paraqitet kodrinor malor dhe pak I aksidentuar. Pothuajse teresisht siperfaqja e zones qe do te shfrytezohet eshte e papyllezuar me perjashtim te shkurreve te ulta dhe te ndonje kullote te pakonsiderueshme te tij.

Vendburimi ka formen e nje strukture monoklinale me shtrirje te pergjithshme, VP – JL dhe me renie Perendimore me kend 20 - 25°.

Kuota me e poshtme e shfrytezimit te objektit eshte +110m dhe me e larta ne varesi te zhvillimit te karrieres shkon **+160m**.

Objekti I kerkuar ben pjese ne zone Perendimore te zones klimatike mesdhetare.

Klima ne rajonin e punimeve paraqitet kontinentale me dimer jo me shume te ftohte dhe me vere relativisht te nxehte.

Dimri pergjithesishte eshte me lageshtire, ndersa vera e nxehte dhe e thate. Ne zone ka mbi 2100 ore ndricim dielli, korriku 345 ore dhe dhjetori 110 ore. Temperatura mesatare vjetore e ajrit eshte 14.80, ne Korrik dhe Gusht temperature shkon ne 33° - 38° ndersa ne janar zbret ne 6°.

Ushtrimi I aktivitetit nuk do te ndikojne ne ndryshimin e parametrave fizike te ajrit dhe nuk do ten dote ate. Parashikimi ne projekt I masave shtese gjate proceseve teknologjike te shfrytezimit si perdorimi I ngarkesave me uje gjate shperthimit te lendeve plasese, shpimi I lagur dhe sperkatja sistematike e stoqeve te gelqerorit dhe rrugeve te transportit do te parandalojne ndritjen e pluhurit dhe ndotjen e ajrit.

Perdorimi I makinerive te ndertimit dhe te transportit te tipit per miniera do te beje te mundur kapjen dhe parandalimin e gazeve qe emetohen nga motorat.

Objekti eshte i lidhur me rruge automobilistike me Uren Vajgurore.

Pjerresia e qete e shpatit ku zhvillohen punimet, favorizon aplikimin e shfrytezimit me sisteme te kombinuara.

Hidrografia, hidrogeologjia,

Osumi eshte nje nga lumenjte kryesore te krahines malore Jugore. Prurja e tij peson luhatje te theksuara gjate vitit. Nga sasia e prurjes se lenget, Osumi ben pjese ne lumenjte mesatare te vendit tone. Ne zone nuk ka burime natyrore ujrash dhe probleme hidrogeologjike.

Demografia, infrastruktura ekzistuese, etj.

Objekti eshte i lidhur me rruget ekzistuese Ure Vajgurore – Berat me nje rruge dytesore te cilat e pershkojne zonen ne kuoten me te larte +110 m. Ne afersi te objektit nuk ka toka

bujqesore,ka disa kariera per shfrytezimin e gurit gelqeror, gje qe favorizon zhvillimin e ketij aktiviteti.

Ekonomia e zonës dhe aktivitetet kryesor

Qendra me e madhe e banuar ne zone eshte Ura Vajgurore, dhe fshatrat Mbreshten, Sinje, etj. Aktiviteti me i perhapur eshte bujqesia dhe blegtoria. Pas viteve 1994 zhvillim te mire ka marre dhe industria e prodhimit e perpunimit te gurit gelqeror, etj...

Ekonomia e zones Aktivitetet kryesore

a. Ekonomia e zones.

Qendra me e madhe e banuar ne zone eshte Ura Vajgurore, dhe fshatrat Mbreshten, Sinje, etj. Aktiviteti me i perhapur eshte bujqesia dhe blegtoria. Pas viteve 1994 zhvillim te mire ka marre dhe industria e prodhimit e perpunimit te gurit gelqeror, etj...

Uji, akuiferet.

Relievi eshte i thjeshte dhe i rregullt; ai vjen e ngrihet nga niveli i Osumit ne Kodren e Gorices me lartesi 99 m, Kodren e Konisbaltes me lartesi 259 m, Mbreshtanin me lartesi 295 m dhe kulmon ne lartesine 1179,2 m te malit te Shpiragut. Objekti eshte i lidhur me rruge automobilistike me Uren Vajgurore.

Pjerresia e qete e shpatit ku zhvillohen punimet, favorizon aplikimin e shfrytezimit me sisteme te kombinuara.

Hidrografia, hidrogeologjia,

Osumi eshte nje nga lumenjte kryesore te krahines malore Jugore. Prurja e tij peson luhatje te theksuara gjate vitit. Nga sasia e prurjes se lenget, Osumi ben pjese ne lumenjte mesatare te vendit tone. Ne zone nuk ka burime natyrore ujrash dhe probleme hidrogeologjike.

Bimesia e zones ku do te zbatohet projekti

Zona klasifikohet si zone pyjore mesdhetare gjithmone e gjelber, me shkurre, zina, koçimarre, shibljak, pseudo-stepa dhe pyje gjetherenes mesdhetare dhe ata kalimtare. Ne keto zona mund te dallohen kater lloje bimesie: bimesi enzore detare te klases Zosteretea, klasa Ammophiletea, qe i takojme edhe gjate dunave me rere, pyll lageshtidashes qe i perket klases Alno Populetea dhe shkurre mesdhetare qe i perkasin klases Quercetea ilicis. Per sa i perket territorive qe perdoren per blegtori, te cilet perbejne pjesen me te madhe te zones se interesuar per kete aktivitet, ne ket zone ne lartesit mbi 300m druret kryesore pyjore jane valanidhi, dushku, hilqja, rrapi, bredhi mesdhetar.

Bimesia mund te klasifikohen ne dy grupe:

1 – Kullota me baze stralli te mbizoteruara nga pirra, Carex curvala, gjembac (Juncus trifidus), Agrostis rupestris, Alopecurus gerardii.

2 - Kullota me baze guri gelqeror te mbizoteruara nga Sesleria korabensis, Carex kitaibeliana, Kobresia Myosuroides, Trifolium aurantiacum dhe Halophila stipulacela.

Tipike e rajonit mesdhetar eshte shkurrja mesdhetare qe eshte e perbere nga lloje gjithmone jeshile (Quercus ilex L., Quercus coccifera L., Artubus unedo L., Myrtus communis L.) dhe peme

mesdhetare.

Zona me interes per shfrytezimin e gurit gelqeror, siç eshte e mundur te shihet nga vete figurat, perbehet nga nje mbulim i dobet bimor. Ne pershkrimin e vegjetacionit kemi sjelle nje numerim te specieve tipike te zones, ndersa mbi kuoten +400m zona paraqitet m disa shkurre sporadike; pjesa tjeter e vegjetimit eshte e perbere nga kullotat dhe speciet e tyre te permendura me lart. Eshte pra e qarte qe efekti mbi sistemin e bimesise nga ky aktivitet dhe per faktin se zona eshte cfaqje guri eshte pothuajse i paperfillshem.

Fauna ne zonen ku do te zbatohet projekti

Ne Shqiperi gjenden 353 specie, prej te cilave vetem disa prej tyre rriten ne territorin e kerkuar per shfrytezim guri gelqeror dhe per rreth tij, kjo varet nga vete habitati ku rritet çdo lloj. Per llojet qe paraqiten me interesante e te pranishme ne zonen qe do te zihet nga ky aktivitet dhe ne rrethinat,me poshte pershkruhen habitatet dhe vendet e banimit.

Faktorët kërcënues

Ndryshimet e regjimit ujqor

Gjatë shfrytezimit te gelqeroreve nuk parashikohet që të ketë ndikime në regjimin ujqor pasi shfrytezimi do te behet ne zone shpat kodre ku nuk ndodhen rrjedha uji si prrenj apo lumenj dhe nuk do te kete devijimi të treupave ujqorë dhe as faktore kercenues ne ndryshimin e regjimit ujqor dhe erozionin e zones.

Shpyllëzimi

Dëmtimi I vegjetacionit pyjqor, sidomos gjatë hapjes se karieres dhe shfrytezimit te shkalles se pare dhe te dyte është faktor negativ.

Nga shpyllëzimet e pyjqeve është rritur dukshëm erozioni, është ulur ndjeshëm numri i shpendëve dhe folezimi i tyre, janë çrregulluar agroekosistemet, ndjehet mungesa e rolit të tyre pastrues, shëndetësor etj. Shfrytezimi gelqeroreve do te behet me kariere nga larte poshte me lartesi shkalle shfrytezimi 10m dhe shesh shkalle ne mbyllje te aktivitetit 3m qe do te pyllezohet.

Per te realizuar kerkesat e projektit sasia e siperfaqes qe do te cvishet nga bimesia dhe qe ne vitet pasardhese do te rehabilitohet do te jete 3.7 ha

Zona qe do te shfrytezohet nuk ka bimesi te larte eshte e mbuluar me shkurre dhe ne vende te vecanta eshte cfaqje shkembore.

Nga ky aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e percaktuar ne VKM nr. 804. dt. 4.12.2003 dhe e listuar ne urdherin e Ministrit nr. 146,dt.8.5.2007

Nga subjekti ne zbatim te projektit do te merren masa qe zona ne shfrytezim te jete gjithmone e kufizuar dhe te rehabilitohet duke u pyllezuar. Ndersa per te menjanuar errozionin nga ujqar e rreshjeve atmosferike ne skarpaten e siperme te shkalleve do te ndertohen kanale dhe kuneta qe ujqrat te drejtohen ne zona qe nuk demtojne token, gjithashtu sheshet e shkalleve te karieres do te hapen me pjerresi nga skarpata e shkalles qe ujqrat te rjedhin ne drejtim te fshatit

Zona me rëndësi të veçantë

Zona e kerkuar per shfrytezimin e gelqeroreve nuk përfaqëson zone me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Startegjisë për “Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme” për tu shpallur “Peisazh i mbrojtur” (Kategoria V sipas IUCNsë). Park kombetar i mbrojtur, etj.

Trashegimia arkitektonike dhe historike

Aktiviteti i shfrytezimit te gurit gelqeror dhe punimet per ndertimin e rruges deri ne shkallen e

pare te shfrytezimit nuk prek zonat turistike, zona te mbrojtura, zona arkeologjike, arkitektonike, objekte te trasheguara dhe te ndertuara nga njeriu me rendesi historike, sepse ne kete zone ato nuk ekzistojne.

Eshte per t'u theksuar se ne kete zone nuk ka monamente kulture, zona arkeologjike dhe gjeomonamente.

Pejsazhi dhe topografi

Siperfaqja ne te cilen do te behet shfrytezimi gelqeroreve, nuk duket nga banoret e fshatrave apo qendrave te banuara perrreth me perjashtim te rasteve per kalimtarete qe udhetojne ne rrugen prane. Duhet theksuar se siperfaqja qe do te shfrytezohet eshte kurrizore kodre me renie nga lindja ne perendim. Profili i kurrizit te kodrave te kesaj zone pergjithesisht eshte gjatesor gati vije drejte me valezime te lehta te sharnierit dhe i pa trazuar nga tektonikat.

Ne disa raste ne kufijte ndares te ketyre kodrave pjerrsia e shpateve eshte shume e thelle dhe keto kufij marrin formen e grykave te thella. Pjerrresia e shpateve lindore eshte me e madhe se ajo e shpateve perendimore.

Me masat qe do merren per rehabilitimin e karrieres gjelberimin me bime qe rriten ne zone, gjat shfrytezimit dhe ne mbyllje te aktivitetit, pejsazhi dhe topografia e zones do te permiresohet dukshem.

Kushtet hidrogjeologjike dhe hidrografike te objektit.

Ashtu sikurse u permend me siper vendburimi perfaqeson nje strukture monoklinale ne formen e nje kodre plotesisht te drenuar dhe nuk ka pembajtje ujrash ne te, me perjashtim te ndonje sasie te vogel ne kuotat e poshtme te cilat jane ne kuoten e rruges qe kalon poshte objektit.

Duke gjykuar nga topografia e terrenit, ndertimi gjeologjik I rajonit, topografia e zones se objekti dhe te dhenat hidrogjeologjike te marra nga punime te tjera te kryera ne terren per qellime te ndryshme, mund te themi se kushtet hidrogjeologjike jane te thjeshta. Dallohen kryesisht ujra te carjeve, debiti I te cilave varet nga rreshjet atmosferike dhe nuk perben ndonje problem te rendesishme per shfrytezimin e objektit.

Nga pikepamja hidrografike, objekti nuk kufizohet me perrenje apo prroska te vogla dhe drejtimi I pergjithshem I rrjedhjes se ujrave eshte ne drejtim Jug – Lindjes, drejt rruges automobilistike te permendur me siper, ku eshte planifikuar te ndertohet nje kanal, I cili do te sherbeje per kullimin e tyre. Prania e ujrave te rreshjeve nuk veshtireson kushtet teknike te shfrytezimit te objektit pasi ato mundt te rrejedhin ne drejtimin e permendur me siper. Mineralizimi I ujrave do te jete I tipit Hidro – Karbonat ,magnezial I perdorshem per tu pire, me vlere maksimale te PH 5.8 – 7.2.

Sizmika

Zona eshte objekt i aktivitetit te forte sizmik. Shperndarja dhe karakteristikat te ketij aktiviteti sizmik jane tashme te njohura.

Termetet jane perqendruar ne disa breza te percaktuar mire nga pikepamja gjeologjike dhe gjeofizike dhe jane objekt i sforcimeve tektonike akoma aktive.

Territori bregdetar i Shqiperise eshte ne nje kontekst sizmo-tektonik dhe mendojme qe ne baze te klasifikimit sizmik te ri (Urdherese e Kryeministritnr. 3274, dt. 20.03.2003) perfshihet ne zonen

sizmike 1, me rrezik te larte, me indeks rreziku $IR = 0,5116$ dhe me intensitet maksimal te vezhguar

$I_{max} \geq 10$ (MCS).

Duke patur parasysh aktivitetin sizmik, zona e projektit eshte klasifikuar, per profilin shtresografik te saj, ne kategorine e meposhtme:

Formacione gjeologjike dhe toka omogjene shume te ngurta te karakterizuara nga vlera te VS30 mbi 800 m/s qe permbajne shtresa te mundeshme me ndryshim siperfaqesor te spesorit jo me shume se 5 m.

Zona ne fjale karakterizohet nga formacione gelqerore, dolomitike dhe gelqerore mellore ne shtrese shtrirese formuar nga aluvionet per pjesen jugore, ndersa ne ate lindore shtresat e permiresojne stabilitetin me nje veshje subvertikale, qe permban formacione kretake.

Kushtet tekniko-minerare.

Kushtet tekniko – minerare

Sic eshte permendur ne pjesen gjeologjike te ketij projekti ne ndertimin gjeologjik te zones se shfrytezimit dhe me gjere sit e gjithe gelqeroret e rajonit ne pergjithesi jane te tipit sedimentar – kimik (T₃ - J₁).

Ato mbulojne te gjithe siperfaqen e zones dhe perfaqesohen nga gelqerore me ngjyre te bardhe me nuance gri massive, me pak shtrese trashed he shtrese holle, me kokrriza me diameter 0.01 – 0.02 mm dhe ne disa raste dhe me te medha.

Gelqeroret ne pergjithesi paraqiten ne forme pakosh te mbivendosura mbi njera – tjetren me alternim te gelqeroreve pak te dolomitizuar dhe me mbushje te materialit allohton, duke pasur nje

shtrirje me azimut shtrirje 170°, azimut renie 260° dhe kend renie 25° - 30°.

Gelqeroret ndahen ne blloqe sipas sistemit te carjeve kryesore me renie Jug – Lindore. Ne object vihen re carje dytesore ne drejtim renire veri – Perendim (kryq te parave) dhe qe zhvillohen ne distance 2 – 4 m (madhesi blloqesh) te carat kane gjeresi 5 – 15 cm dhe jane te mbushura me material alevrolitik e karbonatik me ngjyre kafe te celet.

Depozitimet e tjera marrin qe marrin pjese ne ndertimin gjeologjik nuk kane ndonje ndikin te rendesishem ne zjgedhjen dhe perdorimin e metodes se shfrytezimit.

Shkembijnje karbonatike jane me qendrueshmeri mekanike mbi mesataren deri ne te larte dhe me

system carjesh pak te zhvilluar kryesisht ne pjesen e siperme.

Treguesi I RQD per shkembijnje karbonatike te objektit, sipas studimeve rezulton:

- Ne drejtim te shtrirjes se pakos gelqerore 85 – 87 %.
- Ne drejtim kryq me shtrirjen e structures (sipas renies se shkembijnjeve) 78 – 82%.